

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha me diasporën në SHBA: Krimi i organizuar nuk lejon rotacionin e pushtetit, në 10 vitet e fundit, 4 6% e shqiptarëve janë larguar! Amerika e ka marrë seriozisht luftën kundër karteleve
ADRESA	https://albeu.com/lajme/berisha-me-diasporen-ne-shba-krimi-i-organizuar-nuk-lejon-rotacionin-e-pushtetit-ne-10-vitet-e-fundit-46-e-shqiptareve-jane-larguar-amerika-e-ka-marre-seriozisht-luften-kunder-karteleve/1000055/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 10:45:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 10:44:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bcee873e440be63aac66ae0b9db1322e6aeeb236932c714248e6b695fd0bd556
TEKSTI	2b91be94020f1b4c5cdc50a13aef74e6a5dc2309b15f59c4dfbe3eabbe59079d
PAMJA	efcc563041d370f3205076e8b9bebbe9d001bc894b45d91a46e2ff4450e69de0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5057a0b13cb8ced4f06895f0ce4849d5956eb7f033ffa99cea087a7878d0edf2
E MËPARSHMJA	c00c5d922ca7eb9fed19d0654679ac1729773fdf3b3736ca30c3e8c83a12486
RRËNJA MERKLE	9b0ef5cb548784d84290a5a2cc7ced9efd92dc80ea79fd946771fbc60f10815e
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmdjMmLmnJ4wB8Euqv7vxq3nG8KM5prdDgsKUKfETtSW5Z



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5057a0b13cb8ced4f06895f0ce4849d5956eb7f033ffa99cea087a7878d0edf2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Berisha me diasporën në SHBA: Krimi i organizuar nuk lejon rotacionin e pushtetit, në 10 vitet e fundit, 46% e shqiptarëve janë larguar! Amerika e ka marrë seriozisht luftën kundër karteleve



Gjatë një takimi me diasporën shqiptare në SHBA, kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e cilësoi shpopullimin, ekonominë dhe ndikimin e krimit të organizuar si problemet kryesore me të cilat përballlet Shqipëria.

Berisha tha se mbi 46% e shqiptarëve janë larguar nga vendi gjatë dhjetë viteve të fundit. Ai e lidhi këtë fenomen me atë që e quajti "regjim të drogës" dhe me ndikimin e parave të narkotikëve në ekonomi dhe institucione.

"Krimi i organizuar nuk lejon rotacionin e pushtetit", - Berisha me diasporën në SHBA: Në 10 vitet e fundit, 46% e shqiptarëve janë larguar! Amerika e ka marrë seriozisht luftën kundër karteleve.

Berisha e cilësoi situatën në vend si "ndër më të rëndat" në historinë e Shqipërisë, duke u ndalur veçanërisht te emigracioni masiv.

"Në 10 vjet, nga ajo e keqe e madhe që i ka rënë vendit, mbi 46% e shqiptarëve nuk janë më në Shqipëri", deklaroi Berisha.

Sipas tij, largimi i popullsisë po shoqërohet me pasoja të rënda demografike dhe ekonomike. Ai solli si shembull edhe zonat e thella të vendit, ku mungojnë banorët dhe punëtorët shqiptarë, ndërsa po shtohet prania e punëtorëve të huaj.

Berisha akuzoi qeverinë se ka lejuar krijimin e një sistemi të lidhur me krimin e organizuar dhe narkotikët. Duke folur për zafjedhiet, ai tha se Shqipëria ndodhet përballë një sistemi, ku krimi dhe korrupsion nuk lejojnë

të fundit /



Berisha me diasporën në SHBA: Krimi i organizuar nuk lejon...



Milani rihyn në garë për transferimin e Endrickut nga Real Madridi



Këshilltari i Zelenskyt: Lufta Rusi-Ukrainë mund të përfundojë ...



Jasmin Celikovic ndahet nga Vllaznia pas ndeshjes me...



28 vite në pritje të drejtësisë: Ekspertët vlerësojnë peshën e...



Operacioni "Vjeshta" në Sarandë, 20 persona përfundojnë në prang...



LSDM akuzon qeverinë e Mickoskit për borxh në rritje, çmime më të...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

rotacionin.

"Vendos ministrat, vendos drejtorët e policive, vendos zyrtarët, vendos zgjedhjet. Një nga përfaqësuesit më të shquar të Parlamentit Evropian, që kryesoi ekipin e deputetëve evropianë në vëzhgimin e zgjedhjeve, u tha në parlament kolegëve të tij se në Shqipëri krimi i organizuar nuk lejon rotacionin e pushtetit. Dhe e vërteta është që kjo diktaturë një lloj si e para, zgjedhjet i ka farsë", tha Berisha i cili i beri thirrje diaspores që te denoncojnë tek institucionet e tyre lidhjet mes krimit të organizuar dhe pushtetit.

Fjala e plotë:

Ju faleminderit për mbështetjen e jashtëzakonshme dhe praninë tuaj sot në këtë takim të përbashkët, mbetem shumë njohës dhe falënderues.

Me besim të plotë në rolin e jashtëzakonshëm që ju keni luajtur në të shkuarën dhe do luani dhe tani, në mënyrë që të kapërcejmë një situatë në rrafshin ekzistencial kombëtar, ndër më të rëndat e regjistruar ndonjëherë në histori.

Në 10 vjet, nga ajo e keqe e madhe që i ka rënë vendit, mbi 46% e shqiptarëve nuk janë më në Shqipëri. Disa miq të mi kanë kaluar këto tre-katër ditë në thellësitë më të mëdha të Alpeve. Çfarë u bëri përshtypje? Lëre, ku do gjenin punëtorë filipinas, egjiptianë dhe të kombësive të tjera.

Tani, ky regjim në Tiranë, ndryshe, nuk është një diktaturë totalitare. Jo, nuk ka kampe përqendrimi, nuk ka burgje, nuk ka skuadra pushkatimi. Por ky regjim ka një fuqi helmuese të paparë në historinë tonë, dhe kjo fuqi helmuese është droga. E cila, për të kuptuar rëndësinë e saj, do t'ju them kaq: në asnjë vend të botës në 10 vite, dy monedhat më të fuqishme të planetit, dollari amerikan dhe euro evropiane, nuk kanë pësuar një rënie dramatike, respektivisht 35 dhe 32%, sa kanë pësuar në Shqipëri.

Kaq janë ç'vlerësuar të gjitha eksportet e vendit, me këtë janë shkatërruar, kanë falimentuar me mijëra ndërmarrje. Nuk po flas për zhvlerësimin e remitencave dhe ndihmave që u çoni njerëzve tuaj në këtë shkallë. Pra kjo fuqi e jashtëzakonshme, e cila është një problem planetar, nuk mund të themi se është vetëm problem shqiptar.

Por në Shqipëri, në ekonomi dhe në financa, ka patur efektin më shkatërrimtar se në çdo vend tjetër. Euro është ç'vlerësuar 17% në Meksikë, dollari është ç'vlerësuar 12% në Meksikë. Unë u ndala në këtë aspekt, për të mos thënë aspektin tjetër, që kjo nomenklaturë që ka në dorë këto miliarda, kjo vendos për çdo gjë.

Vendos ministrat, vendos drejtorët e policive, vendos zyrtarët, vendos zgjedhjet. Një nga përfaqësuesit më të shquar të Parlamentit Evropian, që kryesoi ekipin e deputetëve evropianë në vëzhgimin e zgjedhjeve, u tha në parlament kolegëve të tij se në Shqipëri krimi i organizuar nuk lejon rotacionin e pushtetit. Dhe e vërteta është që kjo diktaturë një lloj si e para, zgjedhjet i ka farsë.

Tek po bisedoja me një mikun tim David Philips, që I jam shumë mirënjohës për të gjitha ndjenjat e tij miqësore ndaj shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë dhe më tha, cili është problemi? Problemi themelor për ne është paraqitja e këtij problemi shkatërrimtar për Shqipërinë para miqve, partnerëve tanë, kështu siç është. Ky regjim, kjo diktaturë autokratike, është vite dritë ndryshe nga totalitarja. Komunikimi është jo i lehtë sepse ka një fuqi propagande të jashtëzakonshme dhe ka një fuqi lobuese të pakufishme.

S'po ndalem më shumë, por roli dhe rëndësia e juaj, e secilit prej jush, në paraqitjen e këtij realiteti para përfaqësuesve tuaj, para zyrtarëve të këtij vendi, është ndihma më e madhe që ju mund t'i jepni Shqipërisë dhe unë besoj se do t'ja jepni.

Keni bërë një punë të jashtëzakonshme për lirinë e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës. Por duhet t'ju them këtu, 10 vitet që lamë pas, nga këto faktorë që përmenda, shqiptarët e larguar nga Shqipëria janë mbi dy herë më shumë se shqiptarët e larguar nga Kosova në zbatim të platformës së Çubrilloviçit, që ajo kishte një synim, një qëllim, dëbimin e shqiptarëve nga Shqipëria. Sot, po këto kushte, e gjithë Shqipëria është kthyer në një çiflig të një njeriu, ku investimet në Shqipëri rurale nuk ekzistojnë, ku u shkatërruan shërbimet një lloj siç parashihte platforma, u hiqen bashkitë, komunat, një centralizim i paparë ndonjëherë.

Çfarë, si duhet ta marrim ne këtë? Këtë duhet ta marrim dhe ne e marrim si një detyrim që të vazhdojmë këtë betejë me të gjitha mundësitë tona dhe të falënderojmë zotin. Se në qoftë se atë të parën po të vendosje ta luftoje, në 90% të jepte dyert e burgut ose hapje gropën e varrit. Kjo e dyta të jep mundësi ta luftosh, mund të humbasësh vendin e punës, mund të pësosh gjëra, por nuk pëson ato që pësoje tek e para. Ndaj dhe ne jemi shumë të vendosur ta vazhdojmë këtë betejë. Por thirrja ime dhe ndaj jush, që keni qenë gjithnjë diaspora më e rëndësishme e kombit me një rol shumë të madh, të kontribuoni, të frymëzoni miq, nga po përmend disa emra që kam këtu, si Harri Bajraktari, Sergio Bytyçi, do doja të përmendja shumë të tjerë, të cilët në vitet '90-të në vazhdim bënë gjithçka për Kosovën dhe Shqipërinë. Një kohë e dytë është të përpiqemi të bëjmë gjithçka, përndryshe ky shok demografik që kemi pësuar, në qoftë se nuk ndalohet, në pak dekada më vonë ne do jemi pakicë në vendin tonë.

Asnjëherë nuk ka vend për pesimizëm. Ka një gjë shumë të rëndësishme, që kjo administratë (e SHBA) e ka marrë në mënyrë shumë serioze luftën kundër kartelevë dhe ky është një fat i madh. Ndaj dhe ne do të bëjmë gjithçka të kthejmë në Shqipëri shtetin ligjor, të drejtat e shqiptarëve për të votuar të lirë dhe jo në farsë zgjedhore.

Unë jam shumë besimplotë se kontributi juaj do të jetë, në atë nivel të dashurisë që ju keni për Shqipërinë, të atdhetarizmit tuaj, dhe ju garantoj që edhe ne do bëjmë gjithçka për t'u ndarë me këtë të keqe të madhe.

Unë vij këtu për një vizitë pas disa vitesh, do bëj gjithçka për paraqitjen e realitetit të Shqipërisë tek partneri ynë kryesor dhe në fakt kam shumë besim në mbështetjen dhe në ndihmën e Shteteve të Bashkuara mbasi në këtë rast është interes shumë i madh edhe i këtij vendi. Shqiptarët të dashur miq, sot janë transportuesit kryesorë të

...kështu me interesime t'atit dhe t'atit të tjerë. Shqipëria, të cilat nuk janë transportues dhe të kokainës nga Amerika Latine në Evropë, me distancë nga të tjerët dhe e gjitha kjo është në makinerinë e pushtetit.

Pra, e konsideroj veten me fat që pata mundësi të vij e t'ju takoj ju, me besimin më të madh tek kontributi juaj për të rikthyer në Shqipëri, kushtetutën, ligjin, të drejtat bazë të shqiptarëve

Shtuar më 6.09.2026 12:44

Tags: [Diaspora](#), [krimi](#), [Sali Berisha](#), [SHBA](#), [Shkopullimi](#), [Shqipëri](#)



Operacioni "Vjeshta" në Sarandë, 20 persona përfundojnë në pranga p...



Zjarret e përshtatshme/ Ina Zhupa: Një shkrepëse mund ta shndërrojë zonë...



Vijojnë zjarret në Shqipëri/ 11 vatra ende aktive, problematike situata në...



Tragjedi në Kepin e Gjelbër/ Autobusi me nxënës bie në humnerë,...



Greqia me paketë masash ekonomike/ Pensionistët do marrin 400 euro shtesë ç...



Zjarr në Syrin e Kaltër, digjen 4 kioska, flakët shuhen pas dy orësh



Zjarri në Fier/ Shkuan me makina private për të evakuuar banorët, digjen...



Protesta hyn në ditën e 99-të, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Edi Ramës



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.